

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Sa janë rritur kontributet? 8-mujori, mbi 1.4 miliardë euro derdhen në buxhet nga të punësuarit
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/26/sa-jane-rritur-kontributet-8-mujori-mbi-1-4-miliarde-e-uro-derdhen-ne-buxhet-nga-te-punesuarit/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHÀ


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 11:14:00 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 11:10:03 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4b4cf896b858c9bcf89af4e414ae099606be5ccf2dd445741143bb3a18c96acb
TEKSTI	bb44f38ad6fc21bbd9bc70b907881277c7f48c96396b60990c933e9afe97ab49
PAMJA	41fce1e41368a584ca203dcf332b260fa778d16375c0c451f49a665b1c6f3565

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	356bc256936903af8881237ac310b2f3461536663762b1afe56fdf63dfc74e0e
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	2f94de55f91080d406fb9f0e4354ffa5a46214db9e0928186c4866f36bf6cd6f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/356bc256936903af8881237ac310b2f3461536663762b1afe56fdf63dfc74e0e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Sa janë rritur kontributet? 8-mujori, mbi 1.4 miliardë euro derdhen në buxhet nga të punësuarit

Ekonomi

Publikuar: 26/09/2026



Kontributet në skemën e pensioneve po rriten ndjeshëm nga muaji në muaj. Në 8-mujorin e parë të vitit, mbi 134,1 miliardë lekë apo 1.46 miliardë euro janë derdhur në arkën e shtetit nga të punësuarit në sektorin privat dhe publik, si kontribut për skemën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Të dhënat zyrtare nga Ministria e Financave, tregojnë se për periudhën Janar-Gusht 2026, janë arkëtuar 15.9 miliardë lekë ose 13.4% më shumë se 8-mujori 2025, si dhe me realizim prej 100.4% të planit për 8-mujorin 2026.

Nga ana tjetër kjo shifër është rekord në dekadën e fundit, duke u rritur me 160.9% në raport me vitin 2016, ku të ardhurat nga kontributet ishin në masën 51.4 miliardë lekë.

Ndërsa vetëm në muajin Gusht 2026 janë 16.5 miliardë lekë të mbledhura apo 2 miliardë lekë më shumë. Kjo ecure pozitive e të ardhurave nga kontributet lidhet me një kombinim faktorësh që kanë ndikuar në zgjerimin e bazës së kontribuuesve dhe në rritjen e shumave të deklaruara. Një nga faktorët kryesorë është rritja e pagave në sektorin publik dhe atë privat. Rritja e pagës mesatare në vend, e cila tashmë i është afruar nivelit të 1 mijë eurove në muaj, ka sjellë edhe një rritje të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të paguara për çdo të punësuar.

Në të njëjtën kohë, rezultatet janë ndikuar edhe nga masat për formalizimin e tregut të punës. Kontrollat ndaj nëndeklarimit të pagave dhe nënripiqit për të afruar pagat e deklaruara me të

Me të lexuarat

- Skandali/ Shefin e Komisarit të Fushë-Krujës Elton Shatinin e rrahin me shupllë në masë të SHK-ut hap klinikë kundër plakjes në emrin e Arlinda Mekos (kontabilistja e RSH-shefja e SHISH/ Nuk shantazhoi median, por kërcënoi armiq të e saj Historia e dyshimtë e ankandit të Llatjas, si u bë Kujtim Llupa pronar i Klubit të Elbasanit Me goditje me pasqyrë, duke më rrezikuar jetën"/ Rrëfimi i shefit të Komisarit të Krujës për v...

pagave dhe përpiqet për të ulur pagat e deklaruar me të ardhurat reale kanë zgjeruar bazën mbi të cilën llogariten kontributet. Si rrjedhojë, një pjesë e rritjes së arkëtimeve lidhet edhe me përmirësimin e deklarimit të pagave dhe të punësimit.

Në rritjen e të ardhurave kanë ndikuar gjithashtu pagat referencë të vendosura këtë vit për disa sektorë të ekonomisë, ndër të cilët turizmi, ndërtimi dhe shërbimet mjekësore. Aplikimi i këtyre niveleve synon të kufizojë diferencat mes pagave të deklaruara dhe atyre që praktikohen në treg, duke rritur njëkohësisht edhe bazën e kontributeve të pagueshme.

Një tjetër faktor që ka ndikuar në këtë drejtim është rritja e pagës minimale në 50 mijë lekë në muaj, e hyrë në fuqi nga janari 2026. Me rritjen e bazës minimale të pagës, është rritur edhe detyrimi minimal për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Kontributet janë ndikuar edhe nga zgjerimi i aktivitetit ekonomik dhe rritja e numrit të subjekteve që ushtrojnë aktivitet të deklaruar. Për individët, pagesa minimale mujore për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore aktualisht llogaritet në rreth 13,950 lekë.

TAG:

Kontributet

Sigurimet

Të ngjashme



Çmimet e banesave frenojnë rritjen, por nuk ulen, duhen më shumë muaj për të shitur një apartament



Detajet e rezervës së naftës: Shqipëria krijon asetin strategjik për rastet e krizave



Euro vijon "rrokullisjen", prek rekord të ri në vlerën e 91.4 lekëve

Prapaskena

'Prapaskena' lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. 'Prapaskena' është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësura me interesat klienteliste, krimin dhe biznesit jo të

Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

Kategoritë

KREU INVESTIGIM

KRIM & KORRUPSION DOSJE ROZË

KRYESORE POLITIKË EKONOMI

ANALIZË RAJON KULTURË SPORT

ndershëm, të cilët në bashkëpunim
përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'



Email: [\[email protected\]](#)

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

[Privacy Policy](#) | [Cookies](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.